



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __/__/2018

V E N D I M

Nr. 121 , Datë 15 . 05 . 2018

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.60 Regj., datë 11.05.2018, të z.A. Xh, kundër Departamentit të Administratës Publike¹. Subjekti ankues nuk arrin të përcaktojë shkakun e diskriminimit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Subjekti ankues, z.A. Xh shprehet se ndodhet para një vlerësimi jo transparent dhe subjektiv të Komisionit të Vlerësimit, pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), (për shkak të vonesës së dhënies së rezultatit të shpallur për kategorinë ekzekutive për pranimin në Shërbimin Civil), në shpalljen nr.1661 të DAP. Ankuesi shprehet se vlerësimi i provimit me shkrim i është dhënë pasi ka dhënë intervistën me gojë (një javë më pas), gjë që e bën atë të dyshojë se mund t’i jetë ndryshuar qëllimisht numri i pikëve. Në vijim të kësaj logjike, z.A. Xh pretendon se procesi i vlerësimit nuk ka qenë i rregullt dhe transparent, pasi ai citon se nuk i është bërë vlerësimi i duhur i dosjes së karrierës, sipas Udhëzimit nr.2, datë 27.03.2015 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në Shërbimin Civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme”. Lidhur me këtë subjekti ankues pretendon se nga 13 pikë që ai meritonte, i janë llogaritur 8 pikë dhe kërkon t’i rishikohet provimi me shkrim.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën DAP.

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri të bëjë verifikimin e dokumenteve dhe rivlerësimin e intervistës së provimit me shkrim, verifikimin e dosjes së karrierës për vlerësimin e marrë si dhe duke e krahasuar atë me të gjithë konkurentët e tjerë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Neni 1 i Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstronohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë indicie, lidhur me shkakun e diskriminimit, megjithëse i është kërkuar specifikisht nga specialistja e Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, pranë KMD-së².

Referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet.

² Bazuar në e-mailin e datës 10.05.2018, ora 10:23 A.M dërguar në adresën: xha@gmail.com të subjektit ankues. Subjekti ankues ka dërguar me e-mail dokumentacion plotësues, por sërish nuk ka sjellë asnjë parashtrim apo provë për të faktuar shkakun e diskriminimit të pretenduar.

Komisioni i Shërbimit Civil (KSHC) është një institucion i pavarur, i ngarkuar me mbikqyrjen e menaxhimit të shërbimit civil në të gjitha institucionet që përfshihen në fushën e veprimit të përkatës. Ai është organi administrativ që zgjidh ankimet ndaj vendimeve lidhur me nëpunësin civil.

Lidhur me pretendimin për vendim të padrejtë të DAP-it ndaj tij, Komisioneri informon z.A. Xh se, vendimin e DAP-it mund ta kundërshtojë pranë KSHC-së.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç, 7 dhe 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së znj. A. Xh, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha: Punësim
Shkaku: Çdo shkak tjetër